



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 29.05.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-2121/23, për zyrtarin e lartë z. Alban Nevzati, anëtar i Bordit të Drejtorëve të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, për shkak se:
 - a) nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit;
 - b) është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik;
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Alban Nevzati, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

I. a) - Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë - raportuesi i rastit (DPKI-212123), me pretendimin për konflikt të interesit lidhur me vendimmarrjen e zyrtarit të lartë publik z. Alban Nevzati, anëtar i Bordit të Drejtorëve të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (në vijim: FKEE), me rastin e përzgjedhjes së D. H. në pozitën e Drejtorit Menaxhues të FKEE-së.

Siç është theksuar në raportimin e rastit: "[...] Alban Nevzati (anëtarë i Bordit të FKEE dhe Kryesues i Panelit intervistues me rastin e përzgjedhjes së Drejtorit Menaxhues të FKEE), është bashkëthemelues dhe ish Drejtor i kompanisë Swinto prej Gushti 2021 deri Mars 2023. [...] personi i emëruar për Drejtor Menaxhues të FKEE (D. H.) ka qenë i punësuar në kompaninë Swinto ku z. Alban Nevzati ka qenë bashkëthemelues dhe Drejtor [...]".

Tutje raportuesi i rastit, lidhur me situatën si më lartë, i është referuar shkeljes së nenit 6 të LPKI-së dhe nenit 27 paragrafët 13 dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L 079 për eficiencë të energjisë.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, përkatësisht vetëm pretendimet që lidhen me dyshimin për konflikt të interesit përkitazi me pjesmarrjen e z. Alban Nevzati në procesin e përzgjedhjes së Drejtorit Menaxhues të FKEE-së, në cilësi të kryesuesit të panelit intervistues.

Agjencia nuk ka trajtuar çështjet që lidhen me rregullsinë dhe/apo ligjshmërinë e procesit të përzgjedhjes si më lartë përkatësisht me (mos)plotësimin e kriterëve nga kandidatët, si dhe pretendimet që lidhen me shkeljen e nenit 27 paragrafët 13 dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L. 079 për efikasitet të energjisë, pasi që janë jashtë sferës së konfliktit të interesit dhe nuk janë në mandat të Agjencisë.

Kësisoj, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-06/02-2143/23, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Alban Nevzati, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, zyrtari i lartë në fjalë është njoftuar me shkrim lidhur me denoncimin e raportuesit të rastit dhe me faktet që posedon Agjencia, sa i përket pretendimeve të ngritura për konflikt të interesit. Njëherit, me qëllim të sqarimit të këtij rasti, Agjencia ka kërkuar nga z. Alban Nevzati që në lidhje me pretendimet si më lartë, të paraqet qëndrimet dhe deklaratën e tij, duke përfshirë edhe dokumentacionin që posedon.

Përmes shkresës sqaruese - deklaratës me shkrim dhe dokumentacionit të dërguar në Agjenci (DPKI-06/02-2143/23), z. Alban Nevzati ka paraqitur qëndrimet dhe argumentet e tij karshi pretendimeve të ngritura, duke paraqitur edhe prova të shkruara përkitazi me deklaratimet dhe sqarimet e tij. I njëjti, ndër të tjera ka theksuar se:

Lidhur me çështjen e pjesmarrjes së tij në cilësi të anëtarit të Bordit të FKEE-së përkatësisht Kryesuesit të panelit intervistues dhe vlerësues, në procesin e përzgjedhjes së Drejtorit Menaxhues të FKEE-së, z. Alban Nevzati ka sqaruar se:

"[...] unë jam emëruar si anëtar i Bordit të FKEE-së nga Ministria e Ekonomisë, me datë 11.02.2022 për një mandat 3 vjeçar, sipas nenit 27 (3.1) të Ligjit për Efikasitet të Energjisë 06/L-079. Kurse sa i përket pjesëmarrjes sime në Komisionin Përzgjedhës për Drejtorin Menaxhues, ju informoj se intervistat e kandidatëve për Drejtorin Menaxhues të FKEE-së janë realizuar nga një panel vlerësuesish prej 5 anëtarëve, ku 2 anëtarë duhet të jenë përfaqësues të Bordit. Me vendimet përkatëse të Bordit, të gjitha anëtarët e Bordit janë angazhuar në fazat e ndryshme të procesit meqë ka pasur komisione të veçanta lidhur me hartimin e listës së ngushtë të kandidatëve, lidhur me ankesat e palëve dhe lidhur me intervista. Për shkak të përvojës në procese të ngjashme dhe në procesin e rekrutimit të Drejtorit paraprak të FKEE-së, Bordi ka vendosur që unë të jem në Komisionin e Intervistimit. Një gjë të tillë përcakton edhe Rregullorja përkatëse e FKEE-së. Andaj, gjatë angazhimit tim të panelin intervistues unë nuk kam pasur asnjë situatë që ka të bëjë me të konfliktit të interesit sipas ligjeve në fuqi."

Sa i përket raportit/afërsisë së tij me kandidatin e përzgjedhur D. H., z. Alban Nevzati ka sqaruar se:

"Unë kam qenë njëri nga themeluesit dhe njëri nga aksionarët e kompanisë Swinto S.H.A. që nga themelimi deri më datën 01.03.2023, kur edhe jam tërhequr tërësisht nga të gjitha rolet e kompanisë. D. H. është punësuar në Swinto në Korrik 2021 dhe ka punuar aty deri në Tetor

2023. D. H. së fundmi ka shërbyer si Drejtues i Departamentit të Shitjes, pozitë kjo që ka raportuar tek ud. Kryeshefi Ekzekutiv, H. B., kurse unë kam shërbyer në Bordin Mbikëqyrës të kompanisë deri në Mars 2023. Pra, në kohën kur D. H. i është nënshtruar procesit të rekrutimit në FKEE, unë nuk kam pasur asnjë rol në kompaninë Swinto ose në kompanitë e ndërlidhura me të. Rrjedhimisht, kam vlerësuar dhe kam qenë plotësisht i bindur që pjesëmarrja në panelin intervistues nuk do të ndikon asgjë në profesionalizmin dhe subjektivitetin dhe kjo nuk ka krijuar asnjë situatë të konfliktit të interesit.”

Ndërsa, përkitazi me ndërlidhjen e kompanisë Swinto në Zvicërr me kompaninë Velanis AG dhe kompaninë Swinto Kosovë, si dhe lidhur me raportin e tij me këto kompani, z. Alban Nevzati ka sqaruar se:

“[...] Velanis AG ka qenë kompania në Zvicër që ka zotëruar aksionet e kompanisë Swinto, ku unë kam marrë pjesë me një pjesë jodomimuese. Që nga data 01.03.2023, unë nuk kam mbajtur asnjë aksion ose rol në asnjërën nga kompanitë e përmendura. Për këtë, bashkangjitur e gjeni dëshmitë e dërguar pranë Bankës Qëndrore të Kosovës.”

Përveç kësaj, më qëllim të sqarimit të situatës dhe konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, Agjencia ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) informatat dhe historikun e biznesit Swinto SH.A. Gjithashtu, ka kërkuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) informata lidhur me listën e punëtorëve të deklaruar nga biznesi në fjalë (shkresa zyrtare: DPKI-06/02-44/24).

ARBK duke vepruar sipas kërkesës si më lartë, ka dërguar në Agjenci informatat dhe historikun e biznesit Swinto SH.A., sikurse që edhe ATK ka dërguar përgjigjen me listat e punëtorëve të deklaruar nga biznesi në fjalë, përgjigja zyrtare DPKI-06/02-44-1/24.

Kësisoj, Agjencia pasi ka administruar si prova informatat e pranuar prej raportuesit të rastit, shkresën sqaruese - deklaratën e dërguar në Agjenci nga z. Alban Nevzati, përfshirë dokumentacionin e bashkangjitur, mandej informatat dhe historikun e biznesit Swinto SH.A. të dërguar nga ARBK dhe përgjigjen zyrtarë përfshirë listat punëtorëve të deklaruar nga ky biznes të pranuar nga ATK, si dhe ekstraktet nga regjistri i deklarimit të pasurisë në Agjenci të vitit 2022 dhe 2023 nga z. Alban Nevzati, e ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Me Vendimin e Ministres së Ekonomisë numër protokolli 01-263, i datës 11.02.2022, z. Alban Nevzati është emëruar anëtar i Bordit të Drejtorëve të FKEE-së si përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë.

FKEE ka shpallë konkursin për pozitën Drejtor Menaxhues, i cili konkurs ka qenë i hapur për aplikim nga data 01.08.2023 deri më 21.08.2023.

Me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të FKEE-së numër Ref: R296/2023, i datës 30.08.2023, është themeluar komisioni intervistues për pozitën e drejtorit menaxhues, ndërsa z. Alban Nevzati, në cilësi të anëtarit të Bordit të FKEE-së, është emëruar kryesues i këtij komisioni.

Nga informatat publike në dispozicion në uebfaqen e FKEE-së, rezulton se D. H. është zgjedhur Drejtor Menaxhues i FKEE-së.

Ka qenë jokontestues dhe i pohuar nga vet zyrtari i lartë z. Alban Nevzati, fakti që ai ka qenë pjesë e komisionit intervistues për përzgjedhjen e Drejtorit Menaxhues të FKEE-së, me ç'rast

në këtë pozitë është zgjedhur D. H., andaj Agjencia nuk ka vlerësuar të nevojshme marrjen e provave tjera për konstatimin e këtij fakti.

Nga informata dhe historiku i biznesit Swinto S.H.A. të pranuar nga ARBK-ja, rezulton se njëri nga aksionarët e këtij biznesi është subjekti Velanis AG me seli në Zvicërr (më pas e ndryshuar në Swinto Schweiz AG), në të cilin z. Alban Nevzati ka qenë aksionar dhe Kryetar i Bordit Drejtues.

Referuar informatave si më lartë, z. Alban Nevzati ka qenë drejtor i bordit drejtues të Swinto S.H.A. nga data 04.03.2021 deri më datë 08.12.2023, ndërsa kandidati (D. H.) i cili është pranuar drejtor menaxhues në FKEE, ka qenë drejtor menaxhues në subjektin Swinto S.H.A. nga data 07.10.2021 deri më datë 17.10.2022.

Sipas përgjigjes zyrtare të pranuar nga ATK, përkatësisht listës së pagave të deklaruara në ATK nga subjekti Swinto S.H.A., rezulton se z. Alban Nevzati, ka marrë pagë nga ky subjekt nga muaji Shtator 2021 deri në muajin Mars 2023, ndërsa kandidati (D. H.) i cili është pranuar drejtor menaxhues në FKEE, rezulton se ka marrë pagë nga Swinto S.H.A., nga muaji Korrik 2021 deri në muajin Tetor 2023.

Rrjedhimisht, kandidati (D. H.) i cili është pranuar drejtor menaxhues në FKEE, ka qenë drejtor menaxhues në subjektin Swinto S.H.A. gjatë periudhës kur edhe z. Alban Nevzati ka qenë drejtor i bordit drejtues të subjektit në fjalë, si dhe kohën kur kompania Velanis AG me seli në Zvicërr, në të cilin z. Alban Nevzati ka qenë aksionar dhe Kryetar i Bordit Drejtues, ka qenë njëri nga aksionarët e subjektit Swinto S.H.A.

Me qëllim të sqarimit të statusit të Shoqërisë Aksionare (S.H.A.) dhe raportit të kësaj shoqërie me pronarët/aksionarët, e në drejtim të konstatimit të raportit ndërmjet kompanisë *Velanis AG* me seli në Zvicërr, në të cilin z. Alban Nevzati ka qenë aksionar dhe Kryetar i Bordit Drejtues dhe subjektit *Swinto S.H.A.*, Agjencia i është referuar Ligjit Nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare, ku me nenin 118, paragrafi 1 të këtij ligji është përcaktuar se: "*Shoqëria Aksionare është person juridik në pronësi të Aksionarëve të saj por është juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët. Aksionari i një Shoqërie Aksionare nuk është bashkëpronar dhe nuk ka interes të transferueshëm në pronën ose asetet e Shoqërisë Aksionare. Një Shoqëri Aksionare mund të ketë vetëm një aksionar.*"

Rrjedhimisht, nga konstatimet si më lartë është vërtetuar se kompania *Velanis AG* me seli në Zvicërr, në të cilin z. Alban Nevzati ka qenë aksionar dhe kryetar i bordit drejtues dhe subjekti *Swinto S.H.A.*, në të cilin z. Alban Nevzati (si person fizik) nuk ka qenë aksionar por vetëm drejtor i bordit drejtues, ndërsa kandidati D. H. ka qenë drejtor menaxhues, janë subjekte të ndryshme dhe të ndara nga njëra - tjetra, si dhe janë juridikisht të ndara (të pavarura) nga aksionari/ët.

Andaj, në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. a) të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 dhe nenin 17 lidhur me neni 3 të LPK1-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes* privat për vete apo për *personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare"*, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mtrëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje."*

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *"interes i privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste"*, dhe nënparagrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se: *"Person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin [...]"*

Në rastin konkret, në kuptim dhe zbatim të dispozitave si më lartë, është fakt se z. Alban Nevzati në cilësi të anëtarit të Bordit të Drejtorëve të FKEE-së, ka qenë pjesë e komisionit intervistues për përzgjedhjen e Drejtorit Menaxhues të FKEE-së, me ç'rast në këtë pozitë është zgjedhur D. H., por kandidati në fjalë (D. H.) nuk konsiderohet person i afërm i z. Alban Nevzati. Kjo për faktin se, të qenurit aksionar dhe kryetar i bordit drejtues të një kompanie me seli në Zvicërr (Velanis AG), e cila është aksionar i një shoqërie aksionare në Kosovë (Swinto SH.A.), dhe të qenurit drejtor i bordit drejtues i shoqërisë aksionare në fjalë, ndërkohë që siç u tha shoqëria aksionare (SH.A.) është juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët, *apriori* nuk nënkupton se është person i afërm i z. Alban Nevzati, personi (D. H.) i cili ka qenë drejtor menaxhues i kësaj shoqërie tregtare (Swinto SH.A.).

Kësisoj, pjesmarrja e zyrtarit në *vendimmarrje* dhe ekzistimi i interesit privat apo *interesit të personave të afërm* të zyrtarit në atë *vendimmarrje*, janë kushte *kumulative* të cilat duhet të plotësohen në çdo rast për t'u konsideruar se ka konflikt të interesit në vendimmarrje, sipas dispozitave të nenit 6 dhe nenit 17 të LPKI-së. Në këtë rast, siç është konstatuar më lartë, z. Alban Nevzati ka marrë pjesë në *vendimmarrje* me rastin e pranimi të kandidatit (D. H.) Drejtor Menaxhues në FKEE, por që në këtë rast nuk është plotësuar *kushti tjetër kumulativ*, që është *është interesi i personave të afërm të zyrtarit*.

Andaj, nga sa u tha më lartë, Agjencia si në pikën I. a) të dispozitivit të këtij vendimi.

I. b) - Gjatë procedurës së hetimit administrativ për pretendimet si në pikën më lartë, Agjencia sipas detyrës zyrtare ka identifikuar se z. Alban Nevzati, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik Anëtar i Bordit të Drejtorëve të FKEE-së, njëkohësisht është edhe përfaqësues i

autorizuar në dy biznese private: "Fintr" SH.P.K. (pozita Drejtor Menaxhues) dhe "ODA LAB" O.P. (pozita Agjent i Regjistruar).

Agjencia e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Alban Nevzati lidhur me kufizimet dhe ndalesat për zyrtarët e lartë që parashih LPKI, në raport me të qenurit përfaqësues i autorizuar apo drejtues i ndërmarrjeve private, si dhe të njëjtin e ka udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohej me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit".

Përveç kësaj, me nenin 15 [Transferimi i të drejtave në drejtimin e ndërmarrjes] të LPKI-së, është përcaktuar se: *"1. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e administrimit dhe drejtimit në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj. 2. Zyrtari i lartë, pronari i aksioneve, gjegjësisht pjesës së kapitalit në një ndërmarrje, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet t'i transferojë të drejtat e administrimit ose menaxhimit, apo drejtimit të ndërmarrjes tek ndonjë person i besuar. [...]"*

Zyrtari e lartë z. Alban Nevzati, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka deklaruar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e papajtueshmërisë - konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar informatat se zyrtari e lartë z. Alban Nevzati ka bërë ndryshimet e nevojshme sa i përket biznesit "Fintr" SH.P.K. në të cilin e ka mbajtur pozitën drejtor menaxhues, duke bartur të drejtat e drejtimit të biznesit në fjalë (madje edhe aksionet) tek një person tjetër (personi i besuar). Ndërsa sa i përket biznesit "ODA LAB" O.P. në të cilin z. Alban Nevzati ka mbajtur pozitën e agjentit të regjistruar, ka njoftuar se i njëjti është pasiv që shtatë vite dhe se janë në procedurë të ndryshimeve.

Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari e lartë z. Alban Nevzati, në raport me biznesin "Fintr" SH.P.K. është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3., si dhe nënparagrafi 1.1. lidhur me nenin 15 të LPKI-së, ndërsa sa i përket biznesit "ODA LAB" O.P., Agjencia ka marrë si të mirëqenë pohimin që janë ndërmarrë veprimet për fillimin e procedurave për të bërë ndryshimet në këtë biznes, por që z. Alban Nevzati (deri sa mbanë pozitë të zyrtarit të lartë publik) nuk ka të drejtë që të ushtroj asnjë lloji detyre apo aktiviteti apo të ndërmarrë ndonjë veprim menaxherial, si agjent i regjistruar i këtij biznesi. Për ndryshimet e kërkuara në këtë biznes privat do të mbikëqyret nga Agjencia deri sa të mbyllet procedura.

Andaj, nga sa u tha më lartë, Agjencia si në pikën I. b) të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *"Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë."*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *"Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:


Ylli Duhshka
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)